



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË-SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 69, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”), e në mbështetje të neneve 15 dhe 29, pika 2, lidhur me nenin 24 paragrafi 1 dhe 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.04.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

REFUZOHET- peticioni i Lidhjes Demokratike të Kosovës (në tekstin e mëtejme LDK), dega në Suharekë me numër të protokollit 01-Nr-104-18913, i datës 20.03.2023, për nxjerrjen e vendimit për lejimin e vendosjes së shtatores së Ibrahim Rugova në sheshin “Ibrahim Rugova” në qytetin e Suharekës si dhe të merret zotimi për ndarjen e mjeteve buxhetore për vitin 2024 për ndërtimin dhe vendosjen e shtatores në fjalë.

Neni 2

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-27345
Më datë 27-04-2023



Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI